



01-779

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr. 05/L-03 dt. 21.06.2016, nenit 17 pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dt. 20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës nr. 110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së nr. 06/2017 dt. 23.05.2017 për Caktimin e Procedurave për Përgatitjen dhe Shqyrtimin e Kërkesave për Kushte Ndërtimore, Leje Ndërtimore dhe Leje Rrërimi për Kategorinë e I-rë dhe të II-të të Ndërtimeve, si dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 nr. 350/02-49240/21 dt. 16.03.2021, të pronarëve Aktere Vidishiqi, Sali Ibishi, Ismail Berisha dhe Shaban Hoxha nga Prishtina, me inv. “Fron Park” shpk me seli ne Gjilan dhe me nr. unik identifikues të biznesit 811378737, për plotësim dhe ndryshim të pjesshëm të Zgjidhjes Urbane të miratuar me me Leje Urbanistike 05 nr. 350-22232/1 dt. 22.02.2008 dhe Konkluzion 05 nr. 350-22232/1 dt. 22.02.2008, në lagjen “Kalabria”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 11.11.2021, merr këtë:

V E N D I M

PËR PLOTËSIM DHE NDRYSHIM TË PJESSHËM TË ZGJIDHJES URBANE TË MIRATUAR ME LEJE URBANISTIKE 05 NR. 350-22232/1 DT. 22.02.2008 DHE KONLUZION 05 NR. 350-22232/1 DT. 22.02.2008

I. Plotësohet dhe ndryshohet pjesërisht Zgjidhja Urbane, e miratuar me Leje Urbanistike 05 nr. 350-22232/1 dt. 22.02.2008 dhe Konkluzion 05 nr. 350-22232/1 dt. 22.02.2008.

II. Zgjidhja Urbane plotësohet dhe ndryshohet në bazë të kërkesës 05 nr. 350/02-49240/21 dt. 16.03.2021 të pronarëve Aktere Vidishiqi, Sali Ibishi, Ismail Berisha, Ali Kengji, Dugagjin Zhubi, Virtyt Zhubi dhe Shaban Hoxha nga Prishtina, me inv. “Fron Park” shpk me seli ne Gjilan dhe me nr. unik identifikues të biznesit 811378737, ku njëherit shërben për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor, për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa shumëbanesore dhe afariste, gjegjësisht “Ndërtesa 1”, “Ndërtesa 2” dhe “Ndërtesa 3”, në kuadër të Bllokut “C6”, të tërësisë urbane “C”, të Planit Rregullues “Kalabria”, si dhe në kuadër të Planit Zhvillimor Urban- PZhU, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale 1835-2, 1835-3, 1835-8, ZK. Prishtinë, si dhe pjesë e parcelës 1836-0 ZK Prishtinë me pronar p.sh. Rugët e trajtuar me këmbim me pjesë të parcelës kadastrale nr. 1064-2 ZK Matičan, si dhe me rezervim të “Ndërtesa 3” për pjesën e parcelës kadastrale 7786-1 ZK Prishtinë me pronar p.sh. Drejtoria e Rugëve të Kosovës, e cila sipas geoportalit shtetëror ka nr. 1835-0, për të cilën nuk figurojnë shënime në KCLIS.

III. Lokacioni për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, përfshihet në kuadër të Planit Rregullues “Kalabria”, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01 nr. 35-1146 dt. 27.05.2011, si dhe në kuadër të Planit Zhvillimor Urban- PZhU, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01 nr. 035-181427 dt. 24.09.2013, dhe kjo zonë është e planifikuar me destinim “ndërtim i lartë i përzier”.

Pronarët dhe investitori për kriteret dhe parametrat urban si dhe kushtet e ndërtimit, janë informuar përmes “Informim nga Plani Rregullues Kalabria - PZhU” nr. 04-350/01-32004/21 dt. 19.02.2021, të lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm të Komunës së Prishtinës.

IV. Gjendja ekzistuese e lokacionit- parcelave kadastrale të trajtuara, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, është:

- Nr. 1835-2 ZK. Prishtinë, me $S=2000m^2$, me pronar Aktëre Vidishiçi, "Arë e Klasës 3";
- Nr. 1835-3 ZK. Prishtinë, me $S=250m^2$, me pronar Virtyt e Dugagjin Zhubi, "Arë e Klasës 3";
- Nr. 1835-8, ZK. Prishtinë, me $S=2780m^2$, me pronar Sali Ibishi dhe Ismail Berisha, "Arë e Klasës 3";
- Nr. 1064-2, ZK Matigan, me $S=1634m^2$, me pronar Shaban Hoxha, "Mal i Klasës 3";
- pjesë e parcelës nr. 1836-0, ZK Prishtinë, me $S=461m^2$, me pronar p.sh. Rugët;
- pjesë e parcelës nr. 7786-1 ZK Prishtinë, me $S=799.25m^2$, me pronar p.sh. Drejtoria e Rugëve të Kosovës, e cila sipas geoportalit shtetëror ka nr. 1835-0, për të cilën nuk figurojnë shënime në KCLIS.
- Të drejtat pronësore-juridike për parcelat kadastrale 1835-2, 1835-3, 1835-8 dhe 1064-2 janë private, në bazë të kopjeve të planit dhe certifikatave të njëjësive kadastrale, si dhe parcela kadastrale 1836-0 dhe 7786-1 janë pronë shoqërore;
- Në kuadër të parcelave kadastrale, sipas incizimit gjeodezik të punuar nga gjeodeti Izjadin Sylja me nr. licence 91, është e ndërtuar një ndërtesë shumëbanesore me etazhitet 2B+S+P+3, e pozicionuar brenda vijës ndërtimore;
- Është tokë urbane, me infrastrukturë: rrugë, ujë, kanalizim, elektrikë, etj.;
- Terreni ka pjerrësi të vogël;
- Qasja ekzistuese në parcelat kadastrale është përmes rrugës ekzistuese njëherit edhe e planifikuar sipas PRrU "Kalabria";
- Në kuadër të perimetrit prej 50m' të parcelave kadastrale në fjalë, përfshihen ndërtesa shumëbanesore dhe afariste.

V. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor, për rregullimin e hapësirës dhe realizimin- ndërtimin e ndërtesës së banimit, në kuadër të Planit Rregullues "Kalabria", si dhe në kuadër të Planit Zhvillimor Urban- PZhU, bazuar në parametrat urban të planit:

- Organizimi me qasje në kuadër të parcelës, pozicionimi, gabariti dhe etazhite i ndërtesave, në raport me vijën rregulluese dhe atë ndërtimore, distanca e ndërtesave nga kufiri i parcelës, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Planin e lokacionit – "Situacioni", bashkëngjitur këtij Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;
- Parcelat dhe pjesët e parcelave kadastrale të trajtuara për realizimin e ndërtesës, konkretisht të përfshira- trajtuara brenda vijës rregulluese, janë:
 - 1835-2, me $S=2000m^2$;
 - 1835-3, me $S=89m^2$;
 - 1835-8, me $S=2565m^2$;
 - 1836-0, me $S=461m^2$;
 - 7786-1, me $S=799.25m^2$;**Sipërfaqe totale $S=5914.25m^2$.**
- Parcelat dhe pjesët e parcelave kadastrale të trajtuara për realizimin e ndërtesave, konkretisht të përfshira- trajtuara jashtë vijës rregulluese, janë:
 - 1835-3, me $S=161m^2$;
 - 1835-8, me $S=215m^2$;**Sipërfaqe totale $S=376m^2$.**
- Këmbimi i sipërfaqes së pjesës së parcelës me pronësi p.sh. Rugët 1836-0 ZK Prishtinë me $S=461m^2$, që shtrihet brenda vijës rregulluese, do të këmbëhet me sipërfaqe të parcelës kadastrale nr. 1064-2 ZK Matigan;
- Me këto kushte ndërtimore, në kuadër të parcelave kadastrale, planifikohet të realizohet/ndërtohet kompleksi me ndërtesa shumë banesore dhe afariste, gjegjësisht "Ndërtesa 1"- B+S+P+10, "Ndërtesa 2"- B+S+P+10 dhe "Ndërtesa 3"- B+S+P+7 e cila rezervohet për parcelën kadastrale nr. 7786-1 ZK Prishtinë me pronar p.sh. Drejtoria e Rugëve të Kosovës (*sipas projekti propozimit të prezantuar*), si dhe synohet rregullimi i bllokut, gjegjësisht kompleksit- parcelës ndërtimore në

të cilën përfshihet edhe ndërtesa ekzistuese me etazhitet 2B+S+P+3, konkretisht plotësohet dhe ndryshohet pjesërisht zgjidhja urbane e miratuar me Leje Urbanistike 05 nr. 350-22232/1 dt. 22.02.2008, ku me këtë rast trajtohen edhe parcelat 1836-0 ZK Prishtinë dhe 7786-1 ZK Prishtinë:

- Ndërtesa ekzistuese, bazuar në dokumentacionin e prezantuar, ka këtë sipërfaqe: 2B=1520.94m²; 1B=1520.94m²; S=593.33m²; P=689.07m²; 1=689.07m²; 2=689.07m²; si dhe 3=689.07, që në total janë 6'391.49m² / 3'338.545m² nëntokë + 3'052.945m² mbitokë.
- Ndërtesa e planifikuar "Ndërtesa 1" – B+S+P+7+Nk – +6'080.98m² / 1'177.875m² nëntokë + 4'903.105m² mbitokë;
- Ndërtesa e planifikuar "Ndërtesa 2" – B+S+P+7+Nk – 5'376.83m² / 1'108.455m² nëntokë + 4'268.375m² mbitokë;
- Ndërtesa e planifikuar me rezervim "Ndërtesa 3" – B+S+P+7 – 2099.50m² / 331.50m² nëntokë + 1'768.00m² mbitokë.
- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesave të jetë për banim shumëbanesor dhe për afarizëm, me hapësira përcjellëse si: kthina teknike, depo, hapësira garazhuese, etj. (sipas projekt propozimit të prezantuar);
- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore- brenda vijës rregulluese (ISHP), për vendosjen e ndërtesave në bazë- gabarit të përdhësës ose suterrenit, në bazë të PZhU, është 0.2 deri 0.4:

$$S=5914.25 \times 0.4=2365.70m^2$$

$$\text{Ekzistuese}=593.33m^2 + \text{të planifikuara}=1'493.66 = 2'086.99m^2$$
- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore për nëntokë (ISHN), për vendosjen e ndërtesave në bazë- gabarit të bodrumit, lejohet max. 60% (0.6):

$$S=5914.25 \times 0.6=3548.55m^2$$

$$\text{Ekzistuese}=1520.94 + \text{të planifikuara}=1'871.00 = 3'391.94m^2$$
- Në kuadër të kompleksit të parashihen edhe sipërfaqet gjelbëruese, ku koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore për sipërfaqet gjelbëruese (ISHGJ), me gjelbërim të lartë dhe të ultë, është min. 40%, përjashtimisht kur ndërtohet kulmi me gjelbërim, kjo sipërfaqe mund të jetë së paku 30%:

$$S=5914.25 \times 0.4=2365.70m^2 \text{ ose } S=5914.25 \times 0.3=1774.275m^2 \text{ (me kulm të gjelbër);}$$
- Koeficienti i ndërtimit (ISPN), sipas Planit Rregullues Kalabria dhe PZhU është 2.2. Koeficienti ndërtimor i parcelës kadastrale brenda vijës rregulluese- parcelës ndërtimore, do të llogaritet si në vijim: 100% për etazhet mbi kuotën ±0.00, 50% për etazhet me vëllim mbi 51% mbi tokë- suterren, dhe 0% për etazhet e nëntokës- bodrume, dhe ka sipërfaqe si në vijim:

$$S=5914.25 \times 2.20=13,011.35m^2$$
- Vendimin 01 nr.400-660 dt. 26.05.2008, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, për kompensimin e pronës private të planifikuar për interes publik aplikohet për sipërfaqet e parcelave jashtë vijës rregulluese deri në 20%. Bazuar në sipërfaqen e pjesëve të parcelave kadastrale të përfshira jashtë vijës rregulluese prej S=376m², si dhe raporti i sipërfaqeve jashtë / brenda vijave rregulluese është $S=376 / 5914.25 \times 100 = 6.36\%$, andaj sipas këtij Vendimi, mund të kompensohet/shpronësohet sipërfaqja S=376m², dhe kalkulohet me koeficient ndërtimi 2.20. Pra, sipërfaqja e kompensuar do të jetë:

$$376 \times 2.20 = 827.20m^2$$
- $$\text{Total} = 13,011.35 + 827.20 = 13,838.55m^2.$$

$$\text{Ekzistuese}=3052.945m^2 + \text{të planifikuara}=10'781.60m^2 = 13'834.55m^2$$
- Bazuar në kriteret e planit rregullues dhe PZhU, distanca minimale në mes dy ndërtesave është 1H deri 1.5H (aty ku ka hapje të kthinave primare), kurse distanca minimale nga kufiri i parcelës kadastrale- parcelës ndërtimore, është 0.75H, gjegjësisht 0.5H me kushtin e mos tejkalimit të distancës në mes dy ndërtesave, prej 1H. Ndërsa te fasadat pa ndriçim primar, minimumi i distancës është 7m`.

- Kuota e përdhësës së ndërtesës përcaktohet në raport me kuotën e nivelit të rrugës publike, nga e cila ka qasje parcela, gjegjësisht në krahasim me kuotën zero, por jo më e ulët se kuota e nivelit të rrugës publike dhe ajo është max. 1.2m
- Qasja në parcelë ndërtimore të jetë përmes rrugëve të planifikuara me Planin Rregullues Kalabria;
- Parkimi i makinave për nevojat e pronarëve (shfrytëzuesëve) të ndërtesës kolektive të banimit të sigurohet në parcelën ndërtimore në brendi të bllokut. Për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi, standardi i parkimit respektivisht i garazhimit sipas Rregullores MMPH nr.03/2016 është 1VP/njësi banimore. Për pjesën e afarizmit min. 1VP për 40m² afarizëm sipërfaqe të shfrytëzueshme. Garazhet e ndërtesave kolektive të banimit vendosen në apo nën ndërtesa, në gabaritin e ndërtesës, apo nën tokë jashtë gabaritit të ndërtesës;
- Kompleksi të organizohet edhe me vendparkimet e jashtme, rrugët, shtigjet, trotualet etj;
- Në kuadër të parcelës të parashihet hapësira për grumbullimi e mbeturinave;
- Arkitektura/dukja e jashtme (fasada) e ndërtesës dhe materializimi i saj, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efijencës së energjisë, dhe t'i përshtatet destinimit të ndërtesës së planifikuar, si dhe karakterit dhe kontekstit të zonës;
- Bazuar në nenin III të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës 01 nr. 031-185481 dt. 14.08.2015, për shkaqe të shfrytëzimit efijent të energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet në harmoni me projektin arkitektonik dhe uji i strehëve duhet të derdhet brenda parcelës ndërtimore;
- Aplikimi i të gjithave kushteve dhe kriterëve tjera urbane & arkitektonike të përcaktuar në kriteret & parametrat urban të Planit Zhvillimor Urban- PZhU.

VI. Ndarja / Parcelimi i parcelave kadastrale nr. 1835-3 dhe 1835-8 ZK. Prishtinë, do të bëhet sipas parcelës ndërtimore bazuar në Planin i situacionit – “zgjidhja urbane” dhe manualin e ndarjes së parcelave, punuar nga gjeodeti i licencuar. Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për ndarjen e parcelave të lartcekura, sipas Planit të situacionit-“zgjidhja urbane” dhe manualit të ndarjes së parcelave, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e ndarjes të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarëve dhe investitorit, duke u bazuar në Planin i situacionit-“zgjidhja urbane” dhe manualin e ndarjes së parcelave, i cili është pjesë përbërëse e këtij Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;

VII. Këmbimi i pjesës së parcelës kadastrale 1836-0 ZK. Prishtinë, me pronësi komunale, me sipërfaqe prej 461m², që shtrihet brenda bllokut për ndërtim, do të bëhet me pjesë të parcelës 1064-2 ZK Matičan, e destinuar me destinim publik sipas Planit Rregullues Prishtina e Re- Zona Qendër.

Procedura e Këmbimit të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, pas realizimit të pikës V të këtij Vendimi, në Drejtorinë e Pronës të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarëve/investitorit, bazuar në Ligjin nr. 04/L-144 dt. 22.11.2012, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

VIII. Bashkimi në një parcelë të vetme, i pjesëve të parcelave kadastrale 1835-2, 1835-3, 1835-8 dhe 1836-0 ZK. Prishtinë, do të bëhet sipas parcelës ndërtimore bazuar në Planin i situacionit – “zgjidhja urbane” dhe manualin e bashkimit të parcelave, punuar nga gjeodeti i licencuar. Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për bashkimin e parcelës dhe pjesëve të lartcekura, sipas Planit të situacionit-“zgjidhja urbane” dhe manualit të bashkimit të parcelave, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e bashkimit të bëhet pas realizimit të pikës V, VI të këtij Vendimi, si dhe para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve

ndërtimore dhe me kërkesë të pronarëve dhe investitorit, duke u bazuar në Plani i situacionit-“zgjidha urbane” dhe manualin e ndarjes dhe bashkimit të parcelave, i cili është pjesë përbërëse e këtij Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

IX. Kompensimi / shpronësimi me sipërfaqe ndërtimore i sipërfaqes jashtë vijës rregullues të pjesëve të parcelave kadastrale nr. 1835-3 dhe 1835-8 ZK Prishtinë, gjegjësisht $S=376m^2$, do të bëhet sipas Vendimit 01 nr.400-660 dt. 26.05.2008, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, për kompensimin e pronës private të planifikuar për interes publik, e cila aplikohet për sipërfaqet e parcelave jashtë vijës rregulluese deri në 20%. Sipas kalkulimeve në paragrafin IV të këtij Vendimi, parcela ndërtimore është me sipërfaqe prej $5914.25m^2$. Bazuar në Vendimin 01 nr.400-660 dt. 26.05.2008, dhe raportit të sipërfaqeve të parcelës ndërtimore dhe sipërfaqes jashtë vijës rregulluese (sipërfaqja e pronës private të përfshirë në hapësira me interes publik) përcaktuar në përqindje (%) është $S=376 / 5914.25 \times 100 = 6.36\%$. Andaj sipas Vendimit të lartcekur, mund të kompensohet me sipërfaqe ndërtimore sipërfaqja prej $S=376m^2$. Sipas kalkulimit, sipërfaqja e kompensuar do të jetë $S=376 \times 2.20 = 827.20m^2$.

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, jep PËLQIM për kompensimin / shpronësimin me sipërfaqe ndërtimore për pjesën e parcelave kadastrale nr. 1835-3 dhe 1835-8 ZK Prishtinë, bazuar në Vendimet e lartcekura. Kjo procedurë e kompensimit me sipërfaqe ndërtimore, do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, i cili do të shërbejë si bazë për arritjen e marrëveshjes definitive, në mes të pronarit të parcelave dhe Komunës së Prishtinës, konkretisht Drejtorisë së Pronës.

Sipërfaqet definitive të shpronësimit / kompensimit me sipërfaqe ndërtimore të trajtohet pas ndarjes dhe barazimit të sipërfaqeve të parcelave kadastrale sipas këtij paragrafi të këtij Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

Mos zbatimi i kësaj procedure sipas këtij paragrafi, nga pronari & investitori, për arsye të ndryshme, obligon Drejtorinë e Urbanizmit të Komunës së Prishtinës, të rishikojë sipërfaqet ndërtimore të ndërtesave shumë banesore & afariste, të përcaktuara me këtë vendim për caktimin e kushteve ndërtimore.

Procedura e kompensimit/shpronësimit të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore dhe pas realizimit të pikës V të këtij Vendimi.

X. Kyçja në infrastrukturë - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR “Prishtina”, bëhet me aplikim nga kjo Drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçe në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit, numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin- adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçe nga “Termokos”- Ngrohësja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

XI. Dokumentacioni ndërtimor - projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV, projekt propozimin e prezantuar, “Rregulloren mbi normat minimale teknike për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi”, të MMPH nr. 03/2016 dt. 04.11.2016, bazuar në UA nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje fizike dhe një (1) digjitale, në këtë përmbajtje:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;

- Situacionin - Planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m`, me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin - Planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë, relative dhe absolute;
- Situacionin - "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore-zejtare;
- Detajet e nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë, me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;
- Projektin e organizimit të kompleksit, me rrugë, shtigje, mobiliarin urban, etj;
- Projektin e strukturës së ndërtimit-llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionimin dhe detaje të nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektro-energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçe në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;
- Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçe në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçe në rrjetin e qytetit;
- Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim", bazuar në Vendimin 01 nr. 035-174324 dt.12.07.2016, e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;
- Elaboratin gjeomekanik, në bazë të analizave të terrenit;

XII. Dokumentacioni ndërtimor për Masat Mbrojtëse nga Zjarri të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet nga kjo drejtori në kompetencë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtim të Komunës së Prishtinës, për sigurimin e "Deklaratë" për Masat e mbrojtjes nga zjarri. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar;
- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m`, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin-"zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Kushtet ndërtimore, të caktuara nga Drejtoria e Urbanizmit (kopje);
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të investitorit dhe të hartuesit të planit të mbrojtjes nga zjarri.

XIII. Dokumentacioni ndërtimor për Leje Mjedisore Komunale të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit

Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3) kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;
- Certifikatën për regjistrimin e biznesit;
- Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit.

Së bashku me dokumentacionin ndërtimor për Leje Mjedisore Komunale, të prezantohet edhe dokumentacioni i nevojshëm për ndërtimin e kulmeve të gielbërta

XIV. Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të “Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01 nr. 434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin/investitorin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo Drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore- këtë Vendim, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo Drejtori (kopje);
- Autorizimin për përfaqësim;
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuarit/ve.

XV. Pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore- meqenëse parcela dhe pjesët e parcelave kadastrale të përfshira në këto kushte ndërtimore, në bazë të certifikatave të njësive kadastrale, janë evidentuar me lloj të shfrytëzimit të parcelave “Arë e Klasës 3” dhe parcela 1836-0 “tokë infrastrukturore”, kërkohet që paraprakisht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 dhe 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës, të cilës do t’i ndërrohet destinimi i llojit të shfrytëzimit, do të llogaritet në bazë të sipërfaqes që shtrihet brenda vijës rregulluese, gjegjësisht $S=5115m^2$. Kjo sipërfaqe do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, andaj, kjo Drejtori jep PËLQIM për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore.

Kjo pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, pas realizimit të pikave V, VI dhe VII të këtij Vendimi, si dhe para aplikimit për leje ndërtimore, bazuar në pëlqimin e dhënë në këtë paragraf.

XVI. Pagesa e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas “Rregullore mbi Taksën Administrative për Dhënien e Lejes së Ndërtimit dhe Tarifën për Rregullimin e Infrastrukturës” 01 nr. 434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor/projektin, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së nr. 06/2017 dt. 23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

XVII. Vlefshmëria e Vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

A r s y e t i m

Pronarët Aktere Vidishiçi, Sali Ibishi, Ismail Berisha, Ali Kengji, Dugagjin Zhubi, Virtyt Zhubi dhe Shaban Hoxha nga Prishtina, me inv. "Fron Park" shpk me seli në Gjilan dhe me nr. unik identifikues të biznesit 811378737, me kërkesën 05 nr. 350/02-71499/21 dt. 21.04.2021, i janë drejtuar Drejtorisë së Urbanizmit të Komunës së Prishtinës, për plotësimin dhe ndryshimin e Zgjidhjes Urbane të miratuar me Leje Urbanistike 05 nr. 350-22232/1 dt. 22.02.2008 dhe Konkluzion 05 nr. 350-22232/1 dt. 22.02.2008, e cila do të shërbejë për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor, për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa shumëbanesore dhe afariste, gjegjësisht tri ndërtesa me etazhitet B+S+P+7+Nk dhe B+S+P+7, në lokacionin e përshkruar si në pikën I të këtij Vendimi.

Bashkë me kërkesë, si dhe gjatë procedurës së trajtimit, është prezantuar: Deshmia mbi pronësinë për parcelat kadastrale 1835-2, 1835-3, 1835-8 ZK. Prishtinë dhe 1064-2 ZK Matiçan, si dhe kopjet e planit të tyre; Vërtetim mbi obligimet tatimore të Sali Ibishi nr. 70932/21 dt. 20.04.2021, Aktere Vidishiçi nr. 70932/21 dt. 20.04.2021, të lëshuar nga Drejtoria e Financave e Komunës së Prishtinës; kopje të dokumentit identifikues të Sali Ibishi, Ismail Berisha, Aktere Vidishiçi; Certifikatën e regjistrimit të biznesit "Fron Park" shpk me nr. unik identifikues 811378737; "Informim nga Plani Rregullues Kalabria - PZhU" nr. 04-350/01-32004/21 dt. 19.02.2021; Foto të lokacionit; "Kontratë për ndërtimin e përbashkët dhe rregullimin e raporteve pronësore" lrp nr. 4641/2020 dt. 09.06.2020, e lidhur në mes palëve kontraktuese Aktere Vidishiçi, në cilësinë e pronarit të tokës, si dhe investitorit "Fron Park" shpk me NUI 811378737; "Kontratë për ndërtimin e përbashkët dhe rregullimin e raporteve pronësore" lrp nr. 2764/2020 dt. 28.02.2020, e lidhur në mes palëve kontraktuese Sali Ibishi, në cilësinë e pronarit të tokës, dhe investitorit "Fron Park" shpk me NUI 811378737, si dhe palëve me interes juridik Nua Kenxhi, Ismail Berisha dhe Ali Kengji; "Kontratë për ndërtimin e përbashkët dhe rregullimin e raporteve pronësore" lrp nr. 3157/2020 dt. 10.03.2020, e lidhur në mes palëve kontraktuese Virtyt Zhubi, Dugagjin Zhubi, në cilësinë e pronarit të tokës, dhe investitorit "Fron Park" shpk me NUI 811378737, si dhe palëve me interes juridik "Lin Project" shpk me NUI 810358623; Inçizimin gjeodezik për parcelat kadastrale në fjalë (kopje fizike dhe digjitale), të punuar nga kompania gjeodete "Progis" shpk me NUI 810277766 dhe licence nr. 10; Propozimi për ndarje të parcelave kadastrale, shpronësim, këmbim dhe bashkim në një parcelë të vetme, të punuar nga gjeodeti Ibrahim Junuzi me nr. licence 105; Projektin konceptual dhe ideorë për ndërtesat e planifikuara (kopje fizike dhe digjitale).

Pas shqyrtimit të kësaj kërkeje, Drejtoria e Urbanizmit, bazuar në nenin 13 pika 1.2 të UA të MMPH-së nr. 06/2017 dt. 23.05.2017, ka vendosur njoftimin publik në lokacion me datë 21.05.2021. Ky njoftim publik, sipas rregullativës ligjore në fuqi, ka qëndruar pesëmbëdhjetë (15) ditë në lokacionin në fjalë, gjegjësisht deri më datë 04.06.2021 dhe me që ndërkohë kjo Drejtori nuk ka pranuar ndonjë vërejtje apo sugjerim, është vazhduar me procedurën për caktimin e kushteve ndërtimore.

Pjesë e kësaj zgjidhje/parcele ndërtimore, janë parcelat dhe pjesët e parcelave kadastrale 1835-2, 1835-3, 1835-8 ZK. Prishtinë, pjesë e parcelës 1836-0 ZK Prishtinë e trajtuar me këmbim me pjesë të parcelës kadastrale nr. 1064-2 ZK Matiçan, si dhe pjesë e parcelës kadastrale 7786-1 ZK Prishtinë me pronar p.sh. Drejtoria e Rugëve të Kosovës për të cilën është rezervuar "Ndërtesa 3", e që në total përbëjnë sipërfaqen prej 5914.25m² (brenda vijës rregulluese). Shtuar këtu edhe sipërfaqen jashtë vijës rregulluese prej 376m² bazuar në Vendimin 01 nr. 400-660 dt. 26.05.2008, të Kryetarit të Komunës

së Prishtinës, për kompensimin e pronës private të planifikuar për interes publik aplikohet për sipërfaqet e parcelave jashtë vijës rregulluese deri në 20%, që kjo sipërfaqe sipas koeficientit të ndërtimit bazuar në Planin Rregullues Kalabria, jep sipërfaqen bruto ndërtimore mbitokësore prej 13,838.55m². Në kuadër të këtyre parcelave kadastrale, në bazë të incizimit gjeodezik të prezantuar bashkë me dokumentacionin për kushte ndërtimore, është e ndërtuar ndërtesa shumëbanesore dhe afariste me etazhitet 2B+S+P+3, me sipërfaqe bruto 6'391.49m² / 3'338.545m² nën tokë + 3'052.945m² mbi tokë. Nga sipërfaqja totale bruto ndërtimore mbitokësore pra 13,838.55m², zbresim sipërfaqen aktualisht ekzistuese mbitokësore prej 3,052.945m², mbeten edhe 10,785.605m², ndërsa i kanë planifikuar për ndërtim edhe 10'781.60m². Sipas këtij konstatimi, vërtetojmë se kompleksi në tërësi, nuk e tejkalon densitetin e planifikuar sipas PRrU Kalabria.

Për këtë lokacion, ekziston zgjidhja urbane e miratuar me Konkluzionin dhe Lejen Urbanistike 05 nr. 350-22232/1 dt. 22.02.2008. Me këtë Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore, përmirësojmë pjesërisht këtë zgjidhje urbane për pjesën ku shtrihen parcelat kadastrale të trajtuara me këto kushte ndërtimore në aspektin e distancave, si dhe futen në zgjidhje edhe parcelat kadastrale 1836-0 dhe 7786-1 ZK Prishtinë, të cilat me Lejen Urbanistike 05 nr. 350-22232/1 dt. 22.02.2008 nuk janë trajtuar.

Pas shqyrtimit të kërkesës 05 nr. 350/02-71499/21 dt. 21.04.2021, Drejtoria e Urbanizmit, bazuar në rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit për Ndërtim nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenin 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 04/L-174 dt. 31.07.2013, nenin 7 dhe 8 të UA të MMPH-së nr. 06/2017 dt. 23.05.2017 "për Përcaktimin e Procedurave për Përgatitjen dhe Shqyrtimin e Kërkesave për Kushte Ndërtimore, Leje Ndërtimore dhe Leje Rrërimi për Kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", Drejtoria e Urbanizmit ka konstatuar se kërkuuesi ka prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, dhe se projekti ideor i prezantuar, është në harmoni me destinimin dhe kriteret tjera të Planit Rregullues "Kalabria" dhe Planit Zhvillimor Urban- PZHU për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të Vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Shtojcë: Plani i lokacionit - "Situacioni"; "Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga Plani Rregullues në sistemin koordinativ Kosovaref01" të punuar nga kjo Drejtori; si dhe "Propozim për ndarje, shpronësim, këmbim dhe bashkim të parcelave kadastrale" të punuar nga gjeodeti i licencuar.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë Vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj Drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo Drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror- MMPHI.

Ky Vendim u shtyp në 5 (pesë) kopje identike fizike dhe i dërgohet: Kërkuessit/ve; kësaj Drejtorie; Drejtorisë së Pronës; Qendrës për Shërbim me Qytetarë; dhe në dosje të lëndës.

Kopje elektronike i dërgohet: Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm; dhe Drejtorisë së Kadastrit.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS
05 NR. 350/02-71499/21 DT. 11.11.2021

Zyrtari:
Arber Hamidi

u.d. Udhëheqëse e Sektorit:
Mimoza Berisha Prestreshi

Faqe 9 prej 9

Komuna e Prishtinës
Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242
e-mail: urbanizmi@prishtine.gov.net






Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Pristina - Municipality Of Prishtina



DREJTORIA E URBANIZMIT

SITUACIONI I PARCELAVE ME VIJEN NDERTIMORE DHE
RREGULLUESE NGA PLANI RREGULLUES NE SISTEMIN
KOORDINATIV KOSOVAREF01



Punoi:
Kushtrim Domaneku


Legjenda:

- Vija Rregulluese sipas PRRU
- Vija Ndërtimore sipas PRRU
- Parcelat Kodastrore

Prishtinë: 04.10.2021

Dispozita Urbane - Ndarja e parces me vijë rregullative

ZK Prishtinë parcela nr.1835-2,1835-3,1835-8 dhe 1836-0



Lista e koordinatave,

Nr.	Y	X
1	7512416.177	4721940.272
2	7512426.744	4721935.371
3	7512441.263	4721928.990
4	7512465.023	4721923.010
5	7512485.872	4721920.249
6	7512508.291	4721916.198
7	7512513.932	4721915.179
8	7512520.653	4721911.052
9	7512519.594	4721908.477
10	7512518.721	4721908.239
11	7512506.642	4721912.319
12	7512484.762	4721916.720
13	7512464.183	4721917.720

14	7512435.803	4721926.971
15	7512417.804	4721934.981
16	7512414.622	4721936.394
17	7512410.843	4721888.563
18	7512401.779	4721893.299
19	7512390.580	4721899.160
20	7512389.963	4721899.413
21	7512398.504	4721920.712
22	7512400.584	4721919.982
23	7512412.253	4721915.922
24	7512494.861	4721884.601
25	7512483.780	4721858.192
26	7512456.680	4721868.960
27	7512410.843	4721888.563

Rilevoi Ibrahim Junuzi
(emri dhe mbiemri i gjedeti)

Nr. i licencēs : 105

Nënshkrimi _____

Data e rilevimit 09.10.2021





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja / Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Prishtinë

Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice: 1836-0

Zona kadastrale / Katastarska zona: Prishtinë

Numri i lëndës / Broj predmeta: 04/2021K

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice: Parcelë

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1:

01839-1

Vija Rregullative

01835-3

P.SH.KK Prishtinë
01836-0
S=481m²

01835-2

01835-8

Vija Rregullative

Lista e koordinatave, kodit dhe përshkrimit të tyre / Lista koordinata, kod i njihov opis

Nr.	Y	X
1	7512416.177	4721940.272
2	7512426.744	4721935.371
3	7512441.263	4721928.99
4	7512465.023	4721923.01
5	7512485.872	4721920.249
6	7512508.291	4721916.198
7	7512513.932	4721915.179
8	7512520.653	4721911.052
9	7512519.594	4721908.477
10	7512518.721	4721908.239
11	7512506.642	4721912.319
12	7512484.762	4721916.72
13	7512464.183	4721917.72
14	7512435.803	4721926.971
15	7512417.804	4721934.981
16	7512414.622	4721936.394

Rilevoi / Snimio: Ibrahim Junuzi
(emri dhe mbiemri i gjeodetit kompanisë / ime i prezime gjeodeta/ kompanije)

Nr. i licencës / Br. licence: 105

Nënshkrimi / Potpis:

Data e rilevimit / Datum snimanja: 12.09.2021



Aprovoi / Usvojio:
(emri dhe mbiemri i personit zyrtar/ ime i prezime sluzbenog lica)

Nënshkrimi / Potpis:

Data e aprovimit / Datum usvajanja:



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja / Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Prishtinë


Nr. i njësish kadastrale / Br. katastarske jedinice: 1064-2

Zona kadastrale / Katastarska zona: Matigan

Numri i lëndës / Broj predmeta: 04/2021K

Lloji i njësish kadastrale / Vrsta katastarske jedinice: Parcelë

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1:



Rilevoi / Snimio: Ibrahim Junuzi
(emri dhe mbiemri i gjeodetit kompanisë / ime i prezime geodeta kompanije)

Nr. i licencës / Br. licence: 105

Nënshkrimi / Potpis:

Data e rilevit / Datum snimanja: 11.10.2021



Aprovui / Usvojio:
(emri dhe mbiemri i personit zyrtar / ime i prezime sluzbenog lica)

Nënshkrimi / Potpis: _____

Data e aprovimit / Datum usvajanja: _____

